REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OFLIPJAN

**Departamenti i Prokurimit**

**Data: 04.04.2025**

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Lipjanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit per Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2 ) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 02.04.2025 të parashtruar nga **OE** NIKA PrO- Ing SH.P.K., **Ferizaj, per aktivitetin e prokurimit me titull:** Ndërtimi i infrastrukturës së jashtme të QKMF – Lipjan **me nr të prokurimit: 613-25-851-5-2-1**

# V E N D I M

**I Refuzohet,** kërkesa për ri-shqyrtim OE NIKA PrO- Ing SH.P.K., **Ferizaj, per aktivitetin e prokurimit me titull:** Ndërtimi i infrastrukturës së jashtme të QKMF – Lipjan **me nr të prokurimit: 613-25-851-5-2-1**

**Vërtetohet** Vendimi i AK i publikuara ne platformen e prokurimi i dates: 28.03.2025, i propozuar per kontrate Grup i Operatorëve Ekonomik BEGISHOLLI COMPANY SH.P.K.; R & Rukolli Ferizaj

1. **Mbetet në fuqi Vendimi i AK i publikuar ne Platformen e Prokurimi i dates: 28.03.2025**

2. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të lartëpërmendur.

3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elekronike në adresën : https://e-prokurimi.rks-gov.net.

# Arsyetim

**Përgjigje për pretendimin tuaj te Parë:**

AK me date 28.03.2025 ka bere publikimin e Vendimit B58, dhe ju si OE deri ne diten e fundit nuk keni bere kerkese per qasje ne dokumente dmth si kompani keni qene e pa interesuar dhe me date 02.04.2025 ora 9:20 keni kerkuar qasje ne kete procedure dhe po ne te njejten dite momentin qe zyrtaret tone kane pare kerkesen per qasje ju kemi kthyer pergjigje dhe ju ka dhene qasja prej ores 14:00, dhe gjate qasjes ne dokumente ne si AK ju kemi ofruar te gjithe dokumentacionin e kerkuar nga ana juaj.
*Shiko dokumentin e qasjes te nenshkruar nga ana juaj:*

**REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO**

**KOMUNA E LIPJANIT**

Drejtoria e prokurimit Lipjan

Procesverbal për qasje në dokumentacion

I hartuar në Lipjan me date **02.04.2025**

**NIKA PrO- Ing SH.P.K.:** ka kërkuar qasje në dokumentacion për tenderin e shpallur **Ndërtimi i infrastrukturës së jashtme të QKMF – Lipjan** me nr. të prokurimit 613-25-851-5-2-1

**"NIKA PrO- Ing SH.P.K.:** ka pas qasje në dokumentacion, e **te gjithe OE** njëherit është paisur me dokumentacionin e kërkuar për këtë tender.

**"NIKA PrO- Ing SH.P.K.:**

**Valon Majanci**

**Lipjan 02.04.2025**

**Zyrtar i Prokurimit**

**Fatlum Breznica**

**Ky pretendim i juaji eshte i Pa Bazuar**
**Përgjigje për pretendimin tuaj te Dytë:**

Tek kerkesa 3. Pika l) eshte kerkuar Gersher per demolim betoni dhe prerese e cila montohet ne eskavator min 5T = min 1 cope, Kurse si deshmi eshte kerkuar Deklaratat unike doganore apo faturat e blerjes per mjete e punes, dhe GOE i propozuar per kontrate ka dorzuar DUDIN Doganor sipas kerkesave te AK, dhe ju njoftojme qe AK nuk ka kerkuar deshmi nga web faqet e internetit dhe google por ka kerkuar deshmi DUD doganor apo Fature me specifikim sipas kerkeses qe GOE i propozuar per kontrate ka plotesuar kete deshmi sipas kerkesave te AK-se shiko dudin me specifikim per kete paisje:

Dokumenti Unik Doganor

ZYRA E DESTINIMIT: 3021 MITROVICA-TERMINAL
Referenca doganore: R 21113 19/10/2024
Manifesti: 2024 15323

1 DEKLARATE: IM 4
3: 1 1
5 Emërtimi: 1 | 6 Nr. pakove: 1 | 7 Numri referues: 2024 #71

2 Eksportuesi: FREDERICH GOLLER, 66508 MALWELER/DE

8 Marrësi / Importuesi: Nr 810638453 — N.T.P. " Begisholli " Magj. Ferizaj- Shkup Ferizaj

9 Personi përgjegjës: Nr 810638463 — N.T.P. " Begisholli " Magj. Ferizaj- Shkup Ferizaj

10 Vendi: XK | 11 Vendi i: XS | 12 Detajet e vlerës: 0.00 | 13 P.P.B: 0

14 Deklaruesi: Nr 810544337 — NTSH. Albini " Drilon Islami Ferizaj

15 Vendi dërgues/eksportues: GJERMANIA | 15 V.E. Kodi: a DE b | 17 V.D. Kodi: a XK b

16 Vendi origjinës: GJERMANIA | 17 Vendi i destinacionit: KOSOVA

18 Identiteti dhe nacionaliteti i mjetit transportues në: 02871FL 02366AX XK | 19: nu

20 Kushtet e dërgesës: EXW DR

21 Identiteti dhe nacionaliteti i mjetit aktiv transportues që kalon: 02871FL 02366AX XK

22 Valuta dhe shuma e: EUR 9,520.00 | 23 Kursi i: 1.0000000 | 24 Lloji i: 1 1 transakc.

25 Lloji: 30 | 26 Lloji: 30 Transport | 27 Transportuesi

28 Të dhëna financiare dhe bankare - Kushtet e

29 Zyra doganore hyrëse/dalëse: 3024 PKK JARINJE | 30 Lokacioni i mallrave

31 Paketimi dhe përshkrimi i mallit: Shenjat dhe numrat - Nr i kontenierit - Numri dhe lloji
Shenja & nr: 1
Kontejner
Numri dhe: 1 NG
Lloji: Pa paketim
Makineri për punë publike, ndërtimi ose të ngjashme
Pjes per eskavator VTC50 viti 1996 perdorur
Gersher per demolim betoni dhe prerese armature

32 Artikulli: 1 | 33 Numri tarifor: 84791000 00
34 Kodi origjinës: a DE b | 35 Pesha bruto (kg): 5,000.00
37 Procedura: 4000 000 | 38 Pesha Neto (kg): 5,000.00 | 39 Kuota
40 Dokumenti paraprak/dokumentimi: 1
41 Njësia plotësuese | 42 Çmimi për njësi: 9,520.00 | 43 M.V.: 1

44 Inf. Dokumentet Certifikata dhe Autorizime: Nr. Licencës — D.Vle. — D.Sas
500.00+0.00+0.00+0.00 0.00
D 380
380-12.10.2024
Kodi LSA | 45 Rregullimi: 1.000
46 Vlera Statistikore: 10,020.00

47 Llog. taksave takse:

| Lloji | Baza e taksës | Norma | Shuma | M |
|---|---|---|---|---|
| CD | 10,020.000 | 0.000 | 0.00 | 1 |
| VT | 10,020.000 | 18.000 | 1,803.60 | 1 |
| | | Totali | 1,803.60 | 1 |

48 Llogaria e pagesës | 49 Identifikimi i depos

B DETAJET E LLOGARISE
Mënyra e pagesës: KESH
Numri i Pranimit: L 21103 Data 19/10/2024
Numri Pagesës: Data
Garancioni: 0.00 EUR Data
Totali: 0.00 EUR
Totali taksave: 1,803.60 EUR

50 Principali — Nr — Nënshkrimi | C ZYRA E NISJES

51 Zyra zyrat e tranzitit vendi: Përfaqësuar nga: Vendi dhe data:

52 nuk vlen | Kodi | 53 Zyra e destinacionit dhe vendi

D KONTROLL NGA ZYRA DOGANORE E DESTINACIONIT — Vula | 54 Vendi dhe data
Nënshkimi — Deklaruesi emri i përfaqësuesit: MUHAMED BEQIRI MB0976
Data

**Ky pretendim i juaji eshte i Pa Bazuar**

**Përgjigje për pretendimin tuaj te Tretë:**
GOE kane pasur te bashkangjitur listen e stafit dhe duke u bazuar ne listen e dorzuar kemi kerkuar sqarime shtese per kontratat ose parakontratat e punes per stafin dhe i njejti GOE eshte pergjigjur brenda afateve te caktura permes platforme e prokurimi.
**Ky pretendim i juaji eshte i Pa Bazuar**

**Përgjigje për pretendimin tuaj te Kater:**
Duhet te ju sqarojme qe ju keni pasur qasje ne dokumente sipas kerkeses suaj pasi qe GOE ka pasur sekret afarist dhe te markuara dokumentet e tija juve ju kemi prezantuar te gjitha dokumentet sepse sikur nuk do te kishit pare nuk do kishi mundur qe ti cekni keto pretendime tuaja qe i keni cekur ne kete kerkese per rishqyrtim poashtu ju keni nenshkruar dokumentin per qasje pasi keni pranuar dhe shikuar dokumentet shiko dokumentin me larte.

Sqarim shtese:
Autoritet Kontraktues duke ju referuar nenit 68 dhe 69, lidhur me nrnin 7, te Ligjit per Prokurim Publik **i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 (Versioni i Konsoliduar), nenit 7 te Rregullores per Prokurim Publik 001/2022, versioni i konsoliduar 11.11.2024, interpretimit te dt:24.10.2023, pytja e 31 te publikuar nga KRPP, i ka ofruar qasjen ne versionin e pastruar.**
**Pasi qe OE ka plotesuar kushtet, sipas LPP-se, legjislacion baze dhe i veçant per Prokurim Publik.**

**Sic vijon:**
Autoritet Kotraktues i ka lejuar qasjen sipas LPP-se, në Ofertën OE "BEGISHOLLI COMPANY SH.P.K."." me rastin e ofertimit ka plotësuar aneksin 3 të DT përmes të cilit ka kërkuar nga AK – KUVENDI KOMUNAL LIPJAN, që informatat dhe dëshmitë sipas nenit 68 dhe 69 të këtij ligji të klasifikohen dhe mbesin si sekret afarist për të gjitha palët duke përjashtuar palët e përcaktuara të nenit 7.3 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Sipas kërkesës në fjalë OE "BEGISHOLLI COMPANY SH.P.K." ka kërkuar mbrojtjen e konfidencialitetit komercial me arsyetimin se informacionet apo dokumentet në fjalë nuk kanë të bëjnë me dokumente publike, dhe se vënja e tyre në dispozicion për OE konkurrent apo palët tjera, si dhe zbulimi i qëllimshëm apo nga pakujdesia do të rezultonte me dëmtim material dhe jo material të interesave komerciale legjitime të afarizmit të tij.

AK konsideron se në ketë çështje ka vepruar në përputhje me të gjitha kërkesat e dispozitave ligjore për promovimin e transparencës sipas nenit 10 dhe 11 të LPP- së lidhur me nenin 7 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik si dhe në përputhje me rregullat e përgjithshme administrative sipas nenit 5 dhe 9 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.
**Interpretimit te dt:24.10.2023, pytja e 31 te publikuar nga KRPP, i ka ofruar qasjen ne versionin e pastruar. Në mes të tjerash citoj**

"7.3 Pas publikimit të rezultatit mbi vendimin e AK vetëm informatat e klasifikuara nga OE dhe të pranuara nga AK si sekrete të biznesit do të mbesin sekrete për të gjitha palët duke përjashtuar KRPP, OSHP, përfshirë ekspertin shqyrtues dhe panelin shqyrtues dhe gjykatat kompetente"
**Ky pretendim i juaji eshte i Pa Bazuar**

AK ka zbatuar me përpikëri rregullat e nxjerra nga KRPP,
Drejtori i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lartë ka vendosur si ne dispozitiv.
Këshilla juridike:
Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-së duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

Data: 04.04.2025

Bekim Shabani

Drejtor i Prokurimit